



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Department of Slobodnih Profesija-
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.08/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore, lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P.nr.603/22, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Burbuqe Spahija -Kerveshi, pala ankuese dhe Përmbarduesi Privat, me datë 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-09/2023 i datës 09.02.2023 dhe ankesa e palës ankuese e datës 30.01.2023 **si të Pa Bazuara.**

II. Përmbarduesi Privat si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P.nr.603/22.

A r s y e t i m

Me datën 30.01.2023 pala ankuese ka parashtruar ankesë ndaj përmbarduesit privat, të cilën ankesë e ka plotësuar me datë 07.02.2023, me pretendimin se përmbarduesi privat nuk i është përmbajtur dispozitave ligjore të LPP-së dhe LPK-së, duke lëshuar tre konkluzione të një pas njëshme derisa është në shqyrtim ligjshmëria e konkluzionit të parë.

Bazuar në këtë fakt përmbarduesi ka vepruar në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 5 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, kjo lidhur me nenin 207 par.1 të LPK-së.

Me propozim për komisionin që ndaj përmbauesit të shqiptohet masa ,Vërejtje publike dhe ndalim ushtrimi të profesionit në kohëzgjatje prej 3 muajsh.

Me datën 09.02.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përmbauesit privat, lidhur me veprimet përmbaimore për këtë lëndë.

Përmbauesi Privat, në deklaratën e tij ka deklaruar se pretendimi se përmbauesi ka bërë shkelje duke lëshuar konkluzion,derisa konkluzioni i oparë është në shqyrtim të ligjshmërisë nuk qëndron, sepse me konkluzion organi përmbaues vendos për zbatim të disa veprimeve dhe drejtim të procedurës dhe ndaj tij nuk parashihet mjet i goditjes. Përkundër kësaj përmbauesi ka pritur vendimin e gjykatës, më të cilin është vërtetuar se nuk ka shkelje procedurale në konkluzionin për lirim vullnetar të paluajtshmërisë lëndore.Ankes ne procedurë përmbaimore nuk ka efekt suspenziv dhe nuk e ndalon procedurën.

Me propozim për komisionin që të refuzohet raporti përfundimtar për inicim të procedurës .

Në seancën dëgjimore palët kanë mbetur sikurse në kërkesat e tyre të mëhershme, ku pala ankuese ka deklaruar problemi jone qëndron për një tokë për te cilën jemi ne proces gjyqësor ne Gjykatën Themelore . disa herë me është kërkuar te largohem nga shtëpia . Ne kërkojmë qe përmbauesi te mos vazhdoj me veprimet përmbaimore pasi pas 10 ditësh kemi seancën ne gjykatë për vërtetimin e pronësisë pasi që ne këtë shtëpi jemi nga viti 1999. Letrat te cilët ne disponojmë jemi te strehuar pasi na është djegur shtëpia .

Përmbauesi ka deklaruar se mbetem ne tërësi pranë përgjigjes dhënë me shkrim me dt.24.02.2023, konsiderojmë se kjo procedurë disiplinore është e pa lejuar dhe pa bazuar për arsye se është ngritur mbi bazën e gjoja pretendimeve se përmbauesi ka bere shkelje duke nxjerr Konkluzion dhe nuk ka pritur vendimin e gjykatës për konkluzion. Ashtu siç pretendon pala ankuese te cilat pretendime janë te pa qëndrueshme se unë jam ne fazën e përmbaimit te aktgjykimit për lirimin e palujtshmerisë .

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbauesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së.

Komisioni ka trajtuar të gjitha provat dhe deklaratimet e palëve dhe bazuar në ato vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr.08/2023 datë 14.04.2023

Kryesuese e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaqi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.